

KUJTESË!

I tërhiqet vëmendja të gjithë kandidatëve që të mos futen në sallën e provimit me celular me vete. Është e ndaluar mbajtja e celularit nga ana e kandidatit gjatë zhvillimit të testimit edhe në rastet kur ai është i fikur.

Për të realizuar provimin në disiplinën: "Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë", kandidatëve do tu jepen nga vëzhguesit:

- Testi i provimit,
- Një fletore,
- Një stilolaps

Kandidati nuk duhet të ketë në tavolinën e provimit asnjë material tjetër të paautorizuar. Të gjitha sendet personale të kandidatit do të lihen përpara nisjes së provimit prej tij në një vend që do të sugjerohet nga vëzhguesit e sallës.

Kandidatit nuk i lejohet që të marrë në tavolinën e provimit libra, shënime dhe materiale të tjera përveçse materialeve që do t'i jepen nga vëzhguesit e sallës dhe që do përdoren për zgjidhjen e tezës.

Gjithashtu kandidatët duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit dhe makinen llogaritëse.

Kujdes!

- Kandidatët nuk duhet në asnjë mënyrë të shkruajnë emrin e tyre në fletore dhe as në fletët e tezës.
- Kandidatët duhet të japin përgjigjet e tyre **vetëm në fletore, cdo shënim do të bëhet vetëm tek testi, i cili nuk do të jetë pjesë e sekretimit**. Cdo shënim i tepërt në fletore si nënvizime psh. Pyetja 11; rrumbullakime psh. Pyetja 11, përdorimi i simboleve psh.* ose { } ose shënime të ngjashme gjatë zgjidhjes së ushtrimeve **do të jetë skualifikues**.
- Gjatë zgjidhjes së tezës **ndalohet** përdorimi i lapsit, korrektorit ose dhe stilolapsave me ngjyra dhe stilolapsa të ndryshëm nga ato të shpërndara në fillimin e provimit.
- **Zgjidhja e çdo ushtrimi duhet të jepet në faqe të re, përveç ushtrimeve me alternativa të cilat do të shkruhen në faqen e parë sipas formatit mëposhtë:**

Pyetje me alternativa

- 1 A
- 2 B
- 3 C

....

- Në fletore duhet të tregohet qartë në krye të faqes pyetja dhe numri i pyetjes për të cilin jepet zgjidhja (psh. Pyetja 11). Zgjidhja duhet të

jepet në vijueshmëri në faqet e fletëve të fletores (pra nuk duhet lënë faqe bosh).

- Në rast kur kandidati gjatë përgjigjes kërkon të bëjë një korrigjim të një përgjigjeje të dhënë, fjala ose shprehja duhet të futet në kllapa dhe t'i kalohet një vijë sipër sipas këtij modeli: ~~(standardet ndërkombëtare);~~
- Pas shpërndarjes së testit, kandidatit nuk i lejohet të dalë nga salla e provimit deri në përfundim të kohës së provimit; dhe atëherë vetëm pasi vëzhguesit e provimit të kenë mbledhur të gjitha testet dhe zarfet e vegjël nga tavolinat e kandidatëve dhe të japin udhëzimin për tu larguar.
- Nëse kandidati do të kërkojë të dalë për një kohë të shkurtër nga salla e provimit, ai do të shoqërohet nga një prej vëzhguesve të sallës së provimit.
- Zarfi i vogël do të mbahet i hapur dhe do të mbyllet vetëm nga grupi i verifikimit dhe sekretimit.
- Zarfi i madh do të mbyllet në përfundim të testimit pasi të jetë futur në të zarfi i vogël dhe fletorja e provimit, nga vëzhguesit e sallës në prezencë të kandidatit.
- **Nëse kandidati do të ketë me vete celularin ose paisje të tjera smart kur hyn në sallën e provimit duhet ti deklarojë dhe dorëzojë ato tek vëzhguesit e sallës.**
- Nuk lejohet të përdoret asnjë shenjë që do të shërbente për të identifikuar fletoren. Është e ndaluar të grisen apo të shkëputen fletët e fletores.

Në rast të konstatimit të një shenje si më sipër, personi do të skualifikohet nga provimi në momentin e sekretimit.

Ndalohet komunikimi i kandidatëve me njëri-tjetrin gjatë provimit. Në qoftë se një gjë e tillë ndodh, atëherë vëzhguesit e provimit janë të detyruar të njoftojnë KPAP.

Cdo kandidati do ti jepen dy zarfa – një zarf i madh dhe një zarf i vogël, dhe një fletë ku do të shënohet emri, mbiemri dhe numri i kartës ID i cili do të futet në zarfin e vogël nga grupi i verifikimit dhe sekretimit në momentin e verifikimit të identitetit të kandidatit.

Zarfi i madh do të përdoret në përfundim të testimit për të futur në të bashkë zarfin e vogël, fletoren e provimit me zgjidhjet e testit.

Në përfundim të kohës së provimit, vëzhguesit e sallës nën prezencën e personelit nga ST dhe SM do të mbledhin fletoren me zgjidhjen e testit dhe zarfin e vogël dhe do ti futin të dy materialet në një zarf të madh, i cili vuloset (në pjesën që mbyll zarfin) në momentin e mbledhjes së materialeve nga tavolina e kandidatit në prezencë të tij. Gjithashtu do të mblidhen të gjitha testet e provimit.

Në përfundim të testimit, duhet nënshkruar përbri emrit tuaj në listë, përpara se të dilni nga salla.

Kualifikohen fitues kandidatët që fitojnë mbi 50% të pikëve të testit.

Ju urojmë SUKSESE!

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

Tiranë më, 30 Maj 2019